



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
KOMISIONI I KONKURENCËS

Njoftim per shtyp

Mbi vendimin e Komisionit të Konkurrencës për “Gjobitjen e ndërmarrjeve pjesëmarrëse në marrëveshjen e ndaluar në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në qytetin e Vlorës, si dhe dhënien e disa rekomandimeve për drejtorinë e përgjithshme të tatimeve”

Komisioni i Konkurrencës në mbledhjen e tij të fundit shqyrtoi raportin e hetimit të thelluar “Në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në qytetin e Vlorës” dhe pretendimet e palëve nën hetim në seancën dëgjimore të zhvilluar në ambjentet e Autoritetit të Konkurrencës me datë 19.07.2011.

Prodhuesit e bukës në qytetin e Vlorës në mbledhjen e datës 21.03.2011 kishin vendosur që çmimi i bukës do të rritej me 20 lek si dhe kishin hartuar një vendim i cili u shpërnda në të gjitha furrat e bukës që operojnë në qytetin e Vlorës.

Gjatë inspektimeve rezultoi se shumë subjekte nuk deklarojnë saktë shitjet e kryera duke mos lëshuar kuponin tatimor për të gjitha shitjet. Referuar kuponave tatimorë, vihet re se disa subjekte në orët e mbasdites kanë lëshuar kupona me kërkesën e inspektorëve të Autoritetit të Konkurrencës vetëm 4, 6, 8 apo 11 kupona tatimore, çka tregon qartë shkallën e lartë të informalitetit. Gjithashtu kjo sjellje përbën konkurrencë të pandershme ndaj prodhuesve të bukës që i deklarojnë saktë të gjitha shitjet e kryera, si dhe deformon analizën e konkurrencës së këtij tregu.

Komisioni i Konkurrencës në datë 07.04.2011 mori vendimin Nr 185 “Për marrjen e masave të përkohshme për ndalimin e marrëveshjes në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në qytetin e Vlorës” duke konsideruar dëmin që mund t’i shkaktonte konsumatorëve të qytetit të Vlorës nga sjellja anti-konkurrese e prodhuesve dhe tregtuesve të bukës.

Komisioni i Konkurrencës vlerëson se marrëveshja për rritjen dhe fiksimin e çmimit të bukës masive, e realizuar nga ndërmarrjet nën hetim, përbën një shkelje të rëndë të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, pasi kjo marrëveshje kufizon konkurrencën në këtë treg.

Komisioni i Konkurrencës në vlerësimin e shkeljes së Ligjit merr parasysh edhe disa rrethana lehtësuese si: (i) kohëzgjatja e shkurtër e shkeljes, (ii) bashkëpunimi i palëve

nën hetim me Autoritetin e Konkurrencës gjatë gjithë procedurës, (iii) reagimi i menjëhershëm nga subjektet duke ulur çmimin e tregtimit të bukës masive pas vendimit të Komisionit të Konkurrencës për marrjen e masave të përkohshme, (iv) shkalla e lartë e informalitetit që shprehet në ekzistencën e bizneseve të pa licencuara dhe mos raportimin e saktë të faturave tatimore, (v) mungesa e bilanceve për 12 nga 20 subjekte nën hetim (edhe pas kërkesës për informacion drejtuar Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Vlorë të përsëritur disa herë nga ana jonë).

Advokacia e konkurrencës është një nga synimet kryesore të Autoritetit të Konkurrencës dhe kërkon bashkëveprimin e një sërë institucionesh që me veprimet apo mosveprimet e tyre ndikojnë në konkurrencën mes lojtarëve të tregut. Në këto kushte përdorimi i instrumentit të avokatisë nëpërmjet procedurave hetimore, organizimit të seancës dëgjimore dhe vendimit për masa të përkohshme, së bashku me vendosjen e masave ndëshkuese mundësojnë zbatimin e plotë të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” me qëllimin final sigurimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.

Si konkluzion, Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 4, pika 1, germa (a), nenit 24, shkronja d), nenit 45, pika 1, nenit 70, pika 2, nenit 74, pika 1, germa “a” dhe “b”, si dhe nenit 80 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, vendosi të gjobisë në shumën 10 000 (dhjetëmijë) lekë 16 ndërmarrjet që kanë zbatuar marrëveshjen për fiksimin e çmimit, por kanë ndaluar shkeljen e ligjit pas vendimit të Komisionit të Konkurrencës për masat e përkohshme si dhe me 20 mijë lekë gjobë 4 ndërmarrjet që nuk kanë respektuar vendimin e Komisionit të Konkurrencës për masat e përkohshme.

Gjithashtu, Komisioni i Konkurrencës i ka rekomanduar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të evidentojë shkallën e lartë të informalitetit dhe përdorimin e kasave fiskale tek subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në prodhimin dhe tregtimin e bukës në qytetin e Vlorës.